



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 18.04.2023)*

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:07 dhe mbaroi në orën 14:26.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>3. Irena Plaku</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>4. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>5. Ridvan Hado</i>     | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>6. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>8. Marçela Shehu</i>   | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>9. Yllka Rupa</i>      | <i>(anëtare)</i>         |

*Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësorë, z. Klodian Kurushi.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 3. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 4. Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit 2020 – 2022, për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj.Brikena Ukperaj).

***Ilir Rusi:*** Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Sipas njoftimit të bërë, deklaroj të hapur mbledhjen plenare të datës 18.04.2023, me rend dite: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit 2020 – 2022, për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej, fjalën relatores zonjës Ukperaj.

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 147/a, pika 1 shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 68 e vijues të ligjit “Për statusin”; si dhe në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.263 dhe nr.264, datë 21.11.2019, me vendimin nr. 561, datë 29.12.2022 ka miratuar “Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2023”, duke përfshirë në program për vlerësim periodik 3 – vjeçar, 9 (nëntë) gjyqtarë, si dhe duke përcaktuar prioritetet e planifikimeve 3 – mujore.

Bazuar në dispozitën e mësipërme të cituar nga ana ime, në programin e vlerësimit për vitin 2023 janë përfshirë për vlerësim 3 – vjeçar vetëm 9 gjyqtarë, duke marrë parasysh se për sa i përket gradimeve ata fillojnë me përparësi, çka është parashikuar gjithashtu në program, me

mbërritjen e dosjeve nga organet e rivlerësimit, ndërkohë që Këshilli angazhohet edhe me vlerësimet e përsheptuara në rastet kur gjyqtarët aplikojnë për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë.

Nga ana tjetër, në program është parashikuar që duke marrë parasysh që vlerësimet periodike 3 – vjeçare janë vetëm për 9 gjyqtarë, ky proces vlerësimi nuk ndahet më në programe të veçanta 3 – mujore, por do të zhvillohet në një fazë të vetme. Në kushtet kur tashmë kemi tre nëpunës përgjegjës për vlerësimin, çfarë ka bërë pengesë për fillimin më herët të këtyre vlerësimeve, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i propozon mbledhjes plenare fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020-2022 për 9 (nëntë) gjyqtarët e përfshirë në program, të cilët janë: (lexohen emrat e gjyqtarëve).

Lidhur me burimet e vlerësimit dhe me gjithë procedurën e vlerësimit, ato janë të parashikuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin, në nenin 71 e vijues të këtij ligji, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit nr. 263 dhe nr. 264.

Në pikën e parë të projektvendimit i cili është përgatitur nga ana e Komisionit përcaktohet pikërisht fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2020 – 2022 për 9 (nëntë) gjyqtarët e mësipërm.

Në pikën e dytë të projektvendimit parashikohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin nëpërmjet procedurave të shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatorin, dhe ndërmjet tre nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional të angazhuar deri tani në vlerësimet e gjyqtarëve sipas skemës së re të vlerësimit.

Lidhur me procedurën e shortit që do të zhvillohet për zgjedhjen e relatorit, Komisioni ka vlerësuar që të përfshihen të tre anëtarët e këtij Komisioni, znj. Brikena Ukperaj, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa, duke siguruar një shpërndarje pune të barabartë mes tyre (tre vlerësime secili anëtar). Po kështu, lidhur me numrin e nëpunësve përgjegjës që do të angazhohen në vlerësimin etik dhe profesional sipas këtij projektvendimi, propozohet të përfshihen në short të tre nëpunësit përgjegjës: znj. Esmerilda Habili, znj. Gilda Hoxha dhe znj. Erlanda Agaj, duke siguruar gjithashtu edhe për nëpunësin një shpërndarje të barabartë pune mes tyre (tre vlerësime secili).

Në projektvendim përcaktohet dhe hyrja e tij në fuqi në kuadrin e një akti kolektiv i cili hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Ukperaj!

Ftoj administratën për përgatitjen dhe hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: (emrat e 9 gjyqtarëve).

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Yllka Rupa (3 shirita), znj. Brikena Ukperaj (3 shirita), znj. Irena Plaku (3 shirita).

Futen me radhë shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Erlanda Agaj (3 shirita), znj. Esmerilda Habili (3 shirita), znj. Gilda Hoxha (3 shirita).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Gjyqtari i parë i përzgjedhur z. {...}. Relatore për z. {...} përzgjidhet zonja Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës znj. Erlanda Agaj.

Gjyqtari i dytë i përzgjedhur znj. {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet zonja Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i tretë i përzgjedhur znj. {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet zonja Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës znj. Gilda Hoxha.

Gjyqtari i katërt i përzgjedhur z. {...}. Relatore për z. {...} përzgjidhet zonja Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës znj. Erlanda Agaj.

Gjyqtari i pestë i përzgjedhur znj. {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet zonja Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës znj. Erlanda Agaj.

Gjyqtari i gjashtë i përzgjedhur znj. {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet zonja Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës znj. Gilda Hoxha.

Gjyqtari i shtatë i përzgjedhur z. {...}. Relatore për z. {...} përzgjidhet zonja Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i tetë i përzgjedhur znj. {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet zonja Yllka Rupa dhe nëpunës përgjegjës znj. Esmerilda Habili.

Gjyqtari i nëntë i përzgjedhur znj. {...}. Relatore për znj. {...} përzgjidhet zonja Irena Plaku dhe nëpunës përgjegjës znj. Gilda Hoxha.

***Ilir Rusi:*** Ju faleminderit!

Sipas shortit, në projektvendimin përkatës rezulton që:

Për gjyqtarin z. {...} relatore të jetë znj. Brikena Ukperaj, ndërsa nëpunëse përgjegjëse znj. Erlanda Agaj.

Për gjyqtaren znj. {...} relatore të jetë znj. Irena Plaku, ndërsa nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtarin z. {...} relatore të jetë znj. Irena Plaku, ndërsa nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Për gjyqtaren znj. {...} relatore të jetë znj. Yllka Rupa, ndërsa nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin e saj znj. Esmerilda Habili.

Për gjyqtarin z. {...} relatore të jetë znj. Yllka Rupa, ndërsa nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin e tij znj. Erlanda Agaj.

Për gjyqtaren znj. {...} relatore të jetë znj. Brikena Ukperaj, ndërsa nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin e saj znj. Erlanda Agaj.

Për gjyqtaren znj. {...} relatore të jetë znj. Irena Plaku, ndërsa nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin e saj znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtaren znj. {...} relatore të jetë znj. Yllka Rupa, ndërsa nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin e saj të jetë znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtaren znj. {...} relatore të jetë znj. Brikena Ukperaj, ndërsa nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin e saj të jetë znj. Esmerilda Habili.

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime apo jo.

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me miratimin e projektvendimit përkatës.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit 2020 – 2022, për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2020-2022, për 9 (nëntë) gjyqtarë pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2023.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

- Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj- Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Erlanda Agaj.

- Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Gilda Hoxha.

- Për gjyqtarin z. {...} – Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Esmerilda Habili.

- Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Esmerilda Habili.

- Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Erlanda Agaj.

- Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Erlanda Agaj.

- Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Gilda Hoxha.

- Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Yllka Rupa - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Gilda Hoxha.

- Për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësim znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

***Ilir Rusi:*** Me shqyrtimin e kësaj pike mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ditë të mbarë!

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**